



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 23 mars 2023
Kodi i ZRRE-së: V_1707_2023

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Neni 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 25, Nenin 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenin 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, Nenin 47 dhe Nenin 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 16 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Rregullën Nr. 15/2017 për vendosjen e të hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal (Rregulla për të Hyrat e FSHU);
- Dispozitat e Rregullës Nr. 03/2017 për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit, Transmetimit dhe Tregut (Rregulla për Të Hyrat e OST/OT);
- Dispozitat e Rregullës Nr.05/2017 për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për Të Hyrat e OSH);
- Njoftimin e ZRRE Nr. 015/23 të datës 11.01.2023 për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të Hyrave të Lejuara Maksimale për operatorët e rregulluar;
- Vendimin për të Hyrat e Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut OST/OT, Nr. V_1705_2023;
- Vendimin për të Hyrat e Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes – OSSH, Nr. V_1706_2023; dhe
- Aplikacionin e Furnizuesit me Shërbim Universal (FSHU/KESCO SH.A) për të Hyrat e Lejuara Maksimale për Furnizuesin me Shërbim Universal me energji elektrike, të dorëzuar me datë 23 janar 2023 në ZRRE;

në seancën e mbajtur më 23 mars 2023 nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHEN TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE (në tekstin e mëtejme HLM) për Furnizuesin e Shërbimit Universal (FSHU) për vitin 2023.**



- II. Të Hyrat e Lejuara Maksimale të Furnizuesit me Shërbim Universal për vitin 2023 do të jenë 398,442,759€.
- III. **OBLIGOHET** – Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) që të përgatisë dhe dorëzojë në ZRRE për aprovim propozimin e tarifave të rregulluara me pakicë sipas këtij Vendimi.
- IV. Ky vendim do të zbatohet nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) duke filluar nga 01 prill 2023.

ARSYETIM

- Furnizuesi me Shërbim Universal (FSHU), me datë 5 dhjetor 2022 ka dorëzuar kërkesën për shqyrtim të jashtëzakonshëm në ZRRE.
- ZRRE sipas njoftimit ka theksuar se, në kuadër të monitorimit të vazhdueshëm të sigurisë së furnizimit me energji elektrike, ka analizuar të dhënat aktuale të operatorëve dhe bazuar në ato ka konstatuar se është arritur pragu i mortalitetit i përcaktuar me Rregullat për të Hyrat për operatorët e rregulluar, përkatësisht janë plotësuar kushtet për hapjen e shqyrtimit të jashtëzakonshëm, ku shkaktarët kryesor për tejkalimin e pragut të mortalitetit janë bazuar në mungesën e të hyrave të realizuara dhe të kostove më të larta të energjisë me shumicë krahasuar me ato të parashikuara.
- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më datë 11 janar 2023 ka iniciuar Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të Hyrave të Lejuara Maksimale për operatorët e Rregulluar, duke përfshirë edhe Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU).
- ZRRE po ashtu në njoftimin e saj ka theksuar se me 26 maj 2022 ka iniciuar procesin e shqyrtimit periodik për periudhën e tretë rregullative 2023-2027, dhe njëkohësisht ka theksuar se procesi i shqyrtimit periodik do të vazhdoj paralelisht me procesin e shqyrtimit të jashtëzakonshëm, dhe varësisht nga rrethanat do të shikojë mundësitë e trajtimit të tij në kuadër të këtij procesi.
- ZRRE ka theksuar se do të ndërmerren veprimet e duhura në harmoni me legjislacionin për sektorin e energjisë ashtu që të mos cenohet siguria e furnizimit me energji elektrike.
- ZRRE me datë dhe 23 janar 2023 nga Furnizuesi me Shërbim Universal (FSHU) ka pranuar aplikacionin për të Hyrave të Lejuara Maksimale me energji elektrike për vitin 2023.
- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me 16 shkurt 2023 ka publikuar Raportin Konsultativ-Përshtatja vjetore për FSHU për vitin 2023.
- Raporti Konsultativ ka paraqitur propozimet e ZRRE-së, për të hyrat e lejuara maksimale për të mbuluar ndryshimin e ndjeshëm në kostot e blerjes së energjisë elektrike dhe për të rivendosur furnizimin me energji elektrike për konsumatorët, si dhe raporti është vënë në diskutim publik me synimin që të marrë komentet e palëve të interesit për propozimet e ZRRE-së.



- ZRRE ka shqyrtuar kërkesën e FSHU-së, për Shqyrtim të jashtëzakonshëm dhe është pajtuar se të dhënat faktike dëshmojnë tejkalimin e pragut të materialitetit dhe ka reaguar me kohë për të nisur shqyrtimin e jashtëzakonshëm. Megjithatë, për shkak të datës së dorëzimit të këtij aplikimi, dhe procesit të implementimit të tij, efektshmëria e shqyrtimit të jashtëzakonshëm do të jetë e njëjtë me atë të përshtatjes së rregullt vjetore. Prandaj ZRRE ka marr parasysh ndikimet e vazhdueshme të ngjarjeve të jashtëzakonshme (që e kalojnë pragun e materialitetit) në përshtatjet e rregullta vjetore.
 - ZRRE gjatë konsultimit publik ka pranuar komente nga palë të ndryshme të interesit ndaj Raportit Konsultativ lidhur me HLM të PRR3, dhe atë: Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Sindikata e pavarur Elektrokosova KESCO, Qeveria e Republikës së Kosovës, Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës dhe Furnizuesi me Shërbim Universal – KESCO.
 - Furnizuesi me Shërbim Universal – KESCO ka dorëzuar komentet me datë 03 mars 2023, ndaj Raportit Konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale të Energjisë Elektrike në kuadër të PRR3.
 - ZRRE i ka trajtuar komentet e FSHU që kanë të bëjnë me kostot e blerjes së energjisë me shumicë për vitin 2023, kostot e lejuara me pakicë, kostot e bartshme, përshtatjet, faktorin korigjues të të hyrave dhe komponentët tjerë të kostove, dhe pas vlerësimit dhe analizimit ka ofruar sqarime profesionale dhe të njëjtat i ka përfshirë në raportin përfundimtar për HLM për FSHU.
 - ZRRE po ashtu i ka analizuar edhe komentet e Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Sindikata e pavarur Elektrokosova KESCO, Qeverisë së Republikës së Kosovës, Zyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës, ku pas analizimit dhe vlerësimit profesional ka paraqitur përgjigjet me shkrim të cilat i ka përfshirë në Raportin Përfundimtar.
 - Vlen të theksohet që të Hyrat e Lejuara Maksimale për FSHU do t'i nënshtrohen Procesit të Përshtatjeve të Rregullta vjetore, sipas Rregullës Nr. 15/2017 për Të Hyrat e FSHU-së, të nxjerr nga ZRRE.
 - FSHU/KESCO propozimet për tarifatat të rregulluara me pakicë duhet ti bëjë duke vepruar në pajtim me Rregullën Nr. 15/2017 për Vendosjen e të Hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal (Rregulla për të Hyrat e FSHU).
 - Bordi i ZRRE pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.**
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.**




Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, kryesues


Lutfije Dervishi, anëtar


Gani Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO,
- KEDS,
- KOSTT dhe
- Arkivit të ZRRE-së.